



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:005408
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05653921

**P.nr.504/
21**

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Arlind Sharani, me bashkëpunëtoren profesionale Rona Myftiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.M., nga Prizreni, për shkak të veprave penale zjarr vënie nga neni 322 par. 1 të KPRK-së dhe asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.103-7/2021 të datës 30.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, e cila është mbajtur në shtëpinë e të pandehurit në rr. “.....” nr. me datën 18.04.2024, konform nenit 172 par. 7 lidhur me nenin 281 par. 2 të KPP-së, në prezencën e Prokurorit të shtetit Beqë Shala, të dëmtuarit O.M., të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 30.04.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.M., nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur me, në Prizren, ku edhe jeton në rr “.....” nr., i pa martuar, ka të kryer 6 vite të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal dhe numër të letërnjoftimit,

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Me datë 12.01.2021, rreth orës 23:05 minuta në rrugën “Reshat Karjagdiu” në Prizren, me dashje ndez zjarr në shtëpinë e tij të përbashkët me vëllain O.M., duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm material, në atë mënyrë që i njëjti ishte i vetëm në shtëpi, fillimisht ndez një cigare ku gjatë ndezjes gaca apo zjarri i cigares i bie në kauq, dhe me atë rast me të dalë jashtë shtëpisë, pas 10-15 minutave vëren se po digjej flakë shtëpia dhe menjëherë e lajmëron vëllain – të dëmtuarin Orhan lidhur me rastin, m ç’rast me këtë veprim shkaktonte dëm të konsiderueshëm material.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: Zjarr vënie, nga neni 322 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

II. Me datë, kohë, vend dhe mënyrën e njëjtë si në pikën I të këtij dispozitivi, asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër dhe atë të dëmtuarit E.Z., , në atë

mënyrë që derisa i njëjti kishte në shfrytëzim lokalit e marrë me qira, mobil shop me mbishkrimin “Diti mobile”, i cili gjendej në katin përdhese të shtëpisë së të akuzuarit, ashtu me rastin e ndezjes flakë të shtëpisë së tij, zjarri e kaplon edhe një pjesë të lokalit, ashtu që me rastin e shuarjes së zjarrit nga Brigada e zjarrfikësve në katin e sipërm, nga rrjedha e ujit i është dëmtuar inventari dhe disa pajisje elektronike, me ç’rast i dëmtuari ka pësuar dëm material në vlerë rreth 2,000 euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale *Asgjësim apo dëmtim i pasurisë*, nga neni 321 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074)

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17 par.1, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 371 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPRK-së, të akuzuarit ia shqipton dënimet si në vijim:

- Për veprën nën I të dispozitivit të aktgjykimit dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti
- Për veprën nën I të dispozitivit të aktgjykimit dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

Andaj gjykata konform nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarit e:

G J Y K O N

ME DËNIMIN ME KUSHT, duke ia vërtetuar dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 5 (pesë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

I dëmtuari E.Z., nga fshati Gjinoc, Komuna e Suharekës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Pala e dëmtuar O.M., nga Prizreni, gjatë shqyrtimit fillestar është tërhequr nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që i akuzuari është në gjendje të varfër ekonomike – është shfrytëzues i pensionit të personave me aftësi të përhershme, prandaj lirohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore sepse pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen material të akuzuarit..

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.103-7/2021 të datës 27.04.2021, kundër të akuzuarit M.M., nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprat penale zjarr vënie nga

neni 322 par. 1 të KPRK-së dhe asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale me datë 17.04.2024, gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar shqyrtimi fillestar, mirëpo kjo seancë nuk është mbajtur pasi që nuk ka prezentuar i pandehuri, për të cilin gjykata nga vëllai i tij O.M., (i cili në këtë rast është edhe i dëmtuar) ka pranuar dokumentacionin mjekësor për të pandehurin sipas të cilës del se është i sëmurë dhe i palëvizshëm dhe nuk ka mundësi për të prezentuar në gjykatë. Gjykata bazuar në këto fakte, shqyrtimi fillestar e ka caktuar që të mbahet në vendin ku gjendet i pandehuri, gjegjësisht në banesën e tij me datë 18.04.2024.

Gjyqtari i vetëm gjykues me datë 18.04.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në banesën e të akuzuarit e cila gjendet në rr “Sami Koka” nr. 27, në të cilën seancë ka prezentuar prokurori i shtetit Beqë Shala, i akuzuari M.M., dhe i dëmtuari O.M.. Gjykata ka konstatuar se i akuzuari është në gjendje të palëvizshme por është i vetëdijshëm dhe i aftë që të komunikojë. Ndaj të njëjtit është konstatuar se deri më tani të akuzuarit nuk i është hequr apo kufizuar zotësia e veprimit ashtu që i njëjti është i aftë për të iu nënshtruar gjykimit dhe ka kuptuar natyrën dhe pasojat e procedurës penale që zhvillohet ndaj tij.

I akuzuari, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet dhe ka shtuar se e ndjen keqardhje për rastin që ka ndodhur në ditën kritike, ashtu që është penduar për veprimet e tij, me vëllain e tij – këtu të dëmtuarin O.M., i ka raportet e mira po ashtu i njëjti kujdeset për shëndetin e tij, ka kërkuar nga gjykata që gjatë shqiptimit të dënimit të ketë parasysh gjendjen e tij shëndetësore, ku i njëjti brenda këtyre dy viteve i është nënshtruar operacioneve kirurgjike, me çka edhe gjykatës përmes vëllait të tij i janë deponuar raportet mjekësore.

Prokurori i shtetit Beqë Shala ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe shton se pasi pranimi i fajësisë ka mbështetje të plotë në provat dhe materialet të cilat i përmban aktakuza dhe është bërë në pajtim me dispozitat ligjore të KPPRK-së.

I dëmtuari O.M., nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë dhe ka shtuar se duke marrë parasysh gjendjen në të cilën është i akuzuari, vëllai i tij, ka kërkuar nga gjykata që me rastin e dënimit ta marrë parasysh gjendjen e tij shëndetësore si rrethanë lehtësuese dhe nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari M.M., me dashje ka kryer veprat penale zjarr vënie nga neni 322 par. 1 të KPRK-së dhe asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si nën I dhe II të dispozitivit të Aktgjykimit.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 321 par. 1, është paraparë forma themelore e veprës penale zjarr vënie: *1. Kushdo që ndez zjarrin apo shkakton shpërthimin me qëllim të dëmtimit të pasurisë së personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.*

Në nenin 320 par. 1 është paraparë forma themelore e veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë: *1. Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 322 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.*

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar edhe në gjendjen e vërtetuar faktike, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura, e ka shpallur fajtor të akuzuarin, për shkak të veprës penale zjarr vënie nga neni 321 par.1 KPRK-së dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të akuzuarit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është i gjendjes së rëndë shëndetësore i njëjti është i pa lëvizshëm, në regjim shtrati dhe në kujdes të vazhdueshëm, gjendja e dobët ekonomike-shfrytëzues i pensionit invalidor, pendimin e thellë dhe keqardhjen për kryerjen e veprës penale, koha e kaluar nga kryerja e veprës penale dhe kohës kur çështja është duke u trajtuar përfundimisht nga gjykata dhe që nga ajo kohë i akuzuari nuk ka kryer vepër tjetër penale. Po ashtu, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e tij në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilat i vihen në barrë. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata morri parasysh të kaluarën kriminale të tij, i njëjti nga kjo gjykatë është dënuar me aktgjykime të plotfuqishme dhe atë: P.nr.1032/16 plot. 02.11.2017, P.nr.1/18 plot. 21.06.2018, P.nr.1523/17 plot. 14.09.2017, P.nr.199/03, plot. 25.08.2003, P.nr.666/13 plot. 17.09.2013, P.nr.2302/17 plot. 05.04.2019, P.nr.2246/16 plot. 16.12.19 dhe P.nr.1688/19 plot. 05.02.2020. Prandaj duke pas parasysh të gjitha faktet, arsyet dhe rrethanat e përmendura më lartë, gjykata ndaj të njëjtit ka shqiptuar dënimin me burgim të kushtëzuar, duke qenë i bindur se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar E.Z., , për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko - civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 par.2 të KPP-së.

8.Vendimi për heqjen dorë nga realizimi i kërkesë pasurore juridike

Pala e dëmtuar Orhan Maqiteva gjatë shqyrtimit fillestar deklaroi se heq dorë nga kërkesa pasurore juridike, andaj gjykata vendimi mbi heqjen dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike e ka marrë në kuptim të dispozitës së nenit 460 par.1 të KPP-së.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 452 par.4 lidhur me nenin 450 par. 1 të KPP-së, pasi që i akuzuari është shfrytëzues i pensionit me pa aftësi të përhershme me vendimin e Ministrisë Së Financave, Punës dhe Transferve, Zyra e Pensioneve në Prizren më datë 16.12.2021, numri i dosjes 6035632, dhe se pagesa e tyre në këtë rast do të rrezikonte gjendjen materiale të tij.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.504/21, me datë 18.04.2024

B. Profesionale
Rona Myftiu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Arlind Sharani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.